



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:053736
Datë: 16.04.2024
Numri i dokumentit: 05601085

C.nr.457/20

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtaren Rajmonda Kurteshi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Kompania e Sigurimeve “Illyria” Sh.A, Rr. Sheshi “Nëna Tereza” nr.33 Prishtinë, kundër të paditurit G.D. nga P., me bazë juridike rimbursimin e dëmit të paguar, vlera e kontestit 11,694.00 euro, në seancën e datës 02.04.2024 mori, ndërsa me datën 16.04.2024 përpiloi këtë:

A K T V E N D I M

I. KONSIDEROHET e tërhequr padia e paditësit Kompania e Sigurimeve “Illyria” me seli në Prishtinë, kundër të paditurit G.D. nga P., e parashtruar me datë 18.05.2020, me bazë juridike rimbursimin e dëmit, vlera e kontestit 11,694.00 euro.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Arsyetim

Në këtë gjykatë, paditësi Kompania e Sigurimeve “Illyria”, me seli në Prishtinë, me datë 18.05.2020, ka parashtruar padi, kundër të paditurit G.D. nga P., me baza juridike rimbursimin e dëmit, vlera e kontestit 11,694.00 euro.

Gjykata, me datën 02.04.2024, ka caktuar seancën përgatitore, në të cilën nuk ka prezantuar paditësi edhe pse në shkresat e lëndës ka pasur prova se i njëjti kanë qenë i ftuar në mënyrë të rregullt, në seancë nuk ka prezantuar dhe mungesën nuk e ka arsyetuar. Në seancë ka prezantuar e autorizuar e të paditurit e cila ka deklaruar se propozon që padia e paditësit të konsiderohet e tërhequr pasi që i njëjti e ka pranuar ftesën në mënyrë të rregullt dhe nuk ka prezantuar në seancë.

Sipas nenit 409 par.1 të Ligjit Nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK), përcaktohet se *“Në qoftë se në seancën përgatitore nuk vjen pala paditëse edhe pse është thirrur rregullisht, padia konsiderohet e tërhequr, përveç kur i padituri kërkon që seanca të mbahet në mungesë të paditësit”*. Prandaj në referim të kësaj dispozite ligjore dhe nga arsyet e lartcekurat rezultojnë

se plotësohen të gjitha kushtet ligjore që padia në këtë çështje kontestimore, të konsiderohet e tërhequr.

Gjykata në bazë të nenit 409 par.1, 387 par.1 e lidhur me nenin 450 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.457/20, me datë 02.04.2024

Gjyqtarja,
Rajmonda Kurteshi

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afatin prej pesëmbëdhjete (15) ditëve, pas marrjes së të njëjtit, nëpërmjet kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.